



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the
Secretary General

Nr. 67/2026
Datë: 17/06/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe nenit 26 dhe 44 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, e parashtruar nga znj. Anesa Hoxha nga Instituti i Kosovës për Drejtësi.
2. Obligohet Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Hoxha me datë 5 qershor 2026 ka parashtruar në Ministrinë së Drejtësisë kërkesën për Qasje në Dokument Publike përmes së cilës ka kërkuar Raportet Vjetore mbi Rehabilitimin e Kryerësve të Dhunës për vitet 2024 dhe 2025.

Po ashtu përmes kërkesës, znj. Hoxha ka kërkuar edhe informacione lidhur me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, duke parashtruar tri pyetje ku përgjigjet përkatëse janë ofruar nga Divizioni përgjegjës i Ministrisë së Drejtësisë përmes postës elektronike.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, u vlerësua se dokumentet e kërkuara mund të vihen në dispozicion të kërkueses në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Ridvan Hoti
Sekretar i Përgjithshëm

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi kërkuesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Vendimi i dërgohet:

- Z. Anesa Hoxha;
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrtares përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për qasje në dokumente publike;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.